

**ESMERALDA STRORI**

**NDËRTIMET ME TOGFJALËSHA NË FUSHËN E  
INFORMATIKËS NË GJUHËN SHQIPE**

Informatika si shkencë dhe si teknologji e informacionit përbën një fushë të re dije me vlera të mëdha teorike dhe praktike prandaj dhe studimi i gjuhës së saj përbën një interes të veçantë. Gjuha e informatikës, e marrë në vetvete, është një mikrosistem brenda ligjërimit të specializuar dhe si e tillë ajo ka shumë anë të përbashkëta me të në shfaqjen e dukurive gramatikore dhe të leksikut joterminologjik, pra, terminologjia.

Rrugët e ndërtimit të terminologjisë së informatikës në tërësinë e tyre përmblihen në tri mënyra formimi, mënyra semantike, gramatikore (morfologjike dhe sintaksore) dhe huazimi.

Objekt i këtij punimi do të bëhet krijimi i termave togfjalësha nëpërmjet rrugës sintaksore.

**1. Togfjalësimi**


Krahas formimit të njërive terminologjike me rrugën morfologjike në terminologjinë e informatikës sasia mbizotëruese e termave formohet nëpërmjet togfjalëshave, d.m.th., me rrugën sintaksore. Kjo ndodh për arsye se gjuha e specializuar e ka të pamundur të shprehë të gjitha konceptet e panumërta ekzistuese në fushën përkatëse të dijes. Për këtë arsye vetë gjuha me mjetet e veta i realizon nëpërmjet togfjalëshave të qëndrueshëm. Ata me formën e tyre e paraqesin konceptin më qartë dhe në mënyrë më të tejdukshme. Termat togfjalësh ndërtohen kryesisht, ose nga termat njëfjalësh, në kombinim me terma të tjerë njëfjalësh, ose në kombinim edhe me fjalë të leksikut të përgjithshëm.

Në pjesën më të madhe të rasteve togfjalëshat terminologjikë përmbajnë dy-tri ose më shumë elemente. Në bazë të tyre si element i përcaktuar është një term kyç, ndërsa rreth tij grupohen elementët e tjera që përcaktojnë elementet kyçe, duke qenë pjesë përbërëse e togfjalëshave të shumtë.

Përdorimi i togfjalëshave terminologjikë i jep terminologjisë së informatikës sikurse çdo terminologjie tjetër<sup>1</sup>, karakter sistemor, të lidhur hierarkik, p.sh.

---

<sup>1</sup> H. Pasho, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, "SF", 1885/4, f. 23-30.



Në “*Fjalorin e informatikës anglisht – shqip, shqip-anglisht*”, Prishtinë 2005<sup>2</sup> një pjesë e togfjalëshave të qëndrueshëm kanë formën e shprehjeve terminologjike, p.sh.:

*njohje e karaktereve me ngjyrë të magnetizuar*  
*sistemi i përbashkët i fajlave të internetit*  
*sistem për përpunim i përndarë horizontalisht*  
*program për ndarje të fjalëve në fund të rreshtit*  
*projektim dhe planifikimi me anë të kompjuterit*  
*komiteti këshillëdhënës ndërkombëtar për telegraf dhe telefoni*

Disa terma kanë aftësi më të madhe në krijimin e togfjalëshave si dygjymtyrësh ashtu edhe shumëgjymtyrësh<sup>3</sup>. Në përgjithësi, termat që krijojnë më shumë togfjalësha janë ata terma që spikatin si të tillë në informatikë, si, p.sh.: *kod, sistem, procesor, njësi, fajl*, dhe që janë njësi njëfjalëshe.

**Si kod:** *kod absolut, kod alfabetik, kod bikuinar, kod binar, kod blloku, kod burimor, kod decimal, kod digjital, kod dyadresësh, kod funksioni, kod grupi, kod i aksesit, kod i assemblerit, kod i autorizimit, kod i drejtëpërdrejtë, kod i flamurit, kod i Grejtit, kod i Hamingut, kod i instruksionit, kod i karakterit, kod i kartës, kod i kushtëzuar, kod i makinës, kod i operacionit, kod i pajisjes, kod i pullave, kod i reflektuar, kod i shtetit, kod i tasteve, kod i të dhënave, kod i veprimt, kod i zgjedhjes, kod interpretues, kod mnemonik, kod njëadresësh, kod optimal, kod parashtesor, kod pesënivelësh, kod postar, kod redundant, kod relativ, kod rreshtor, kod shifre, kod shkronjash, kod shumëadresësh, kod vetëkontrollues, kode lineare, kode të statusit, kodi EBCDIC, kodi i Bodit, kodi i gabimit, kodi i Millerit*. Siç shihet vetëm me njësinë *kod* formohen rreth 53 togfjalësha. Siç mund të kuptohet aftësi shumë të mëdha për të krijuar togfjalësha kanë në mënyrë të veçantë ata terma që shprehin konceptet specifike të fushës si *kompjuter, adresë* etj.

Përveç njërive dygjymtyrëshe përdoren edhe togfjalësha tregjymtyrësh, kurse togfjalëshat me mbi tri gjymtyrë janë në numër të kufizuar.

Trigjymtyrësh: *kod binar ciklik, kod i gjuhës së makinës, kod i identifikimit të mesazhit, kod i pavarur nga pozicioni, kod i segmentimit të të dhënave, kod me gjatësi fikse, kod për kontroll të gabimit, kod për korrigjimin*

<sup>2</sup> Shembujt janë përzgjedhur nga *Fjalori i informatikës anglisht-shqip, shqip-anglisht*, Prishtinë, 2005.

<sup>3</sup> Shih H. Pasho 1.

*e gabimeve, kod për zbulim të gabimit, kod për zbulimin e gabimeve, kode të statusit të HTTP.*

Katërgjymtyrësh: *kod i identifikimit të rrjetit të të dhënave.*

Pesëgjymtyrësh: *kod i numrit dhjetor të koduar binarisht, kod standard amerikan për shkëmbim të informacioneve.*

Po kështu ka një sërë fjalësh të tjera me të cilat krijohen togfjalësha të qëndrueshëm terminologjikë në sasi të madhe. Në “*Fjalorin anglisht-shqip, shqip-anglisht*”, Prishtinë 2005, takojmë një varg termash me aftësi të lartë togfjalëshformuese, si: *kohë, kodim, njësi, regjistër, protokoll, program, pikë, numër, memorie, kontroll, hapësirë, format, formë, disk, bllok, algoritëm* etj.

## 2. Marrëdhëniet ndërmjet gjymtyrëve

Midis gjymtyrëve të togfjalëshave terminologjikë krijohen marrëdhënie të llojeve të ndryshme konceptore<sup>4</sup> të cilat i japin kësaj terminologjie karakter sistemor, të lidhur e hierarkik.

Këto marrëdhënie mund të jenë:

a) ndërmjet pjesës dhe së tërës

*fajl i adresave, fajl i bibliotekës, figurë e karakterit, faqe e kodit, faqe e fontit, segment i kodit.*


b) ndërmjet objektit dhe procesit që realizohet në të

*makinë për përpunimin e të dhënave, modem përgjigjës-nisës, modem përgjigjës - pranues, operator për fshirje.*

c) ndërmjet objektit dhe vetisë së tij

*hapësirë virtuale, kalendar elektronik, kartelë grafike, numëruar digjital, një vendarritje, pemë logjike, operacion logjik.*

d) të gjinisë dhe të llojit



e) ndërmjet objektit dhe funksionit

*port komunikimi, pajisje transmetuese, pikë e hyrjes, pikë hyrëse.*

f) ndërmjet procesit dhe objektit

*bartje e të dhënave, bashkëndarje e të dhënave, bërje e kopjes rezervë, ndarje e diskut, ndërprerje e faqes.*

Mund të vërehet se në terminologjinë e informatikës kemi përfshirjen dhe të një sërë fjalësh të zakonshme (*pemë, pikë*) të cilat, hyjnë në marrëdhënie me fjalë të tjera a terma duke shprehur anë të veçanta të

<sup>4</sup> A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në gjuhën shqipe*, “SF”, 1982/4, f. 109-122.

objekteve dhe koncepteve të ndryshme të fushës së informatikës kështu, p.sh., *pemë e direktorimit, pemë harduerike, pemë e sintaksës abstrakte, pikë e aksesit në rrjet, pikë e indeksit, pikë tipografike* etj.

### 3. Prejardhja burimore

Meqenëse gjuha shqipe nuk mund t'i mbulojë me përbërjen leksikore që ka në kuadrin e termave njëfjalësh të gjitha konceptet e fushës së informatikës, huazon në sistemin e saj terma të huaj. Kështu mes termave krijohen marrëdhënie të ndryshme si: i huaj + i huaj; shqip+i huaj; shqip+shqip. Përdorim më të gjerë të ka tipi i togfjalëshave në kombinime të elementeve përbërëse me strukturë shqip+i huaj dhe anasjelltas.

#### a) shqip+shqip:

*pemë e prejardhjes, pemë e vendosjes, kanal kthimi, gjuhë kryesore, hyrje shtese, kohë e pritjes, kohë e ngritjes, kusht i hyrjes, lexim me kërkesë, listë e gabimeve, luftë e shenjtë.*

#### b) shqip+i huaj:

*përshtatës i displejit, pllakë digjitalizimi, portë e memories, prishje harduerike, rrënjë virtuale, rrjedhë bitesh, shndërrim binar, tabelë elektronike, tip i fajlit, zgjatës i magjistrales.*

#### c) i huaj+shqip:

*disk i jashtëm, buffer i punës, bit i papastër, bit i flamurit, tast për ndihmë, tast i ikjes, sortim i jashtëm, softuer i ndihmës, relacion i nxjerrë, procesor kryesor.*

#### d) i huaj+i huaj:

*aplikacion intranet, alokim i memories, akumulator primar, akses i komutuar, konsol i displejit, konstruktim i kompiluesit, magjistrale e aksesit, magjistrale e multipleksuar, memorie associative, memorie kriogjenike.*

### 4. Përbërja leksikore

Ndërtimi i togfjalëshave mund të vështrohet edhe nga pikëpamja e anës leksikore të elementeve përbërëse të tyre, d.m.th., nëse ato janë vetë terma ose jotërma, pra, fjalë të zakonshme a të përgjithshme.

Dallohen katër grupe:

#### a) fjalë + fjalë

Rastet e kombinimit të dy fjalëve të leksikut të përgjithshëm, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë një term, nuk takohen shpesh në këtë terminologji, megjithatë ato janë të mundshme.

*bardhë e zi, fole për zgjerim, fund i faqes, fund i fushës, fytyrë për fytyrë, gabim i njeriut, e gjelbër e çeltë.*

#### b) fjalë + term (ose fjalë e ngritur në term+term)

Edhe ky rast përdoret në këtë terminologji edhe pse në sasi jo të konsiderueshme.

*pikë e aksesit, mi mekanik, tufë elektronike, shteg i diskut, portë e memories, pllakë modem, pjesë e kodit, pemë e direktorimit.*

**c) term + fjalë**

Një kombinim i tillë haste më shpesh pasi si bazë është termi që përmban ngarkesën kryesore konceptore i cili shërben edhe për formime të shumta, si:

*dupleks i plotë, disk i jashtëm, buffer i punës, tast për ndihmë, session i fundit, server i ngarkuar, server i pangarkuar.*

**d) term + term**

Një njësi e tillë, e përbërë nga dy elemente terminologjike del si specifike e terminologjisë së informatikës. Element i përcaktuar i togfjalëshit del përgjithësisht si term kyç rreth të cilit grupohen terma të tjerë si: *displej digjital, disk optik, direktorium i serverëve, diodë laser, çip kliper, bobinë reaktance, bit akumulatori, audioshirit digjital, video interaktive, tastierë ergonomike, telemetri digjitale, server i aplikacioneve, set i karaktereve, sajt beta, printer i karaktereve, makroinstruksion deklarativ.*

**5. Përbërja leksiko-gramatikore**

Togfjalëshat mund të vështrohen edhe nga ana e përbërjes së elementëve të tyre si kategori leksiko-gramatikore. Në bazë të togfjalëshit terminologjik është emri. Dallojmë disa lloje lidhesh:

**a) emër + emër:**

*mbajtëse e pemës, marrës i të dhënave, strukturë e fajlit, tregues i adresës, njohje e figurës, kontrollues i pajisjes, hapësirë e memories, impuls i shifrës, klasë e sigurimit.*

**b) emër + mbiemër:**

*klasë themelore, kënd i ngushtë, karaktere të zgjeruara, disk i jashtëm, bus i brendshëm, assembler absolut, aplikacion kryesor, akses i drejtpërdrejtë, shteg i plotë, shteg i gabuar.*

**c) emër + parafjalë + emër:**

*varësi nga pajisja, zhvendosje nga tema, zyrë pa letër, zbatim në fond, ushqim me fletë, transistor me bashkim, testim me anë të kompjuterit, tast për një cikël, tastet për filtrim.*

**d) emër + emër + mbiemër:**

*shumëzim i numrave të plotë, shtypshkrim me shkronja të zeza, shifër me peshën më të vogël, shënim me pikë lëvizëze, rrjet me fije optike, rutinë për përpunim të fundit.*

**e) emër + mbiemër + emër:**

*zgjedhje automatike e numrave, zhvendosje dinamike e programit, shkallë e pranueshme e sigurisë, regjistrim i gabueshëm i rreshtit, politikë e pranueshme e shfrytëzimit.*

**f) emër + mbiemër + mbiemër:**

*video digjital i regjistrueshëm, shtresë e hollë magnetike, shpejtësi lineare konstante, qark logjik kombinatorik, qark logjik sekuencial, gjuhë markuese deklarative.*

## **6. Prejardhja e elementeve përcaktuese**

Togfjalëshat mund të analizohen edhe nga përbërja morfologjike fjalëformuese e elementeve të tyre: gjymtyrët përbërëse mund të ndahen në emra, mbiemra të parmë e të prejardhur.

### **emër + emër i paprejardhur:**

*lidhje e vijave, mbajtëse e penës, ngjeshje blloku, ngjeshje e memories, gjatësi e fjalës, pako disqesh, sirtar i letrës, hapësirë disku, gjerësi e kolonës.*

### **emër + emër i prejardhur:**

*fajl i nënshkrimit, njohje e dorëshkrimit, listë e përndarjes, kartelë për përhapje, kartelë e përshpejtuesit, pikë degëzimi, pikë përndarje.*

### **emër + mbiemër i parmë:**

*ndalim i plotë, mod optik, memorie paralele, mbledhësi i parë, kopje e keqe, kopje e saktë.*

### **emër + mbiemër i prejardhur:**

*letër e pandërprerë, gramatikë e dykuptimshme, pemë e parenditur, punë grupore, aparat fotografik, Cd e palexueshme, font burimor, gabim i pariparueshëm, gjuhë jokontekstuale, kompjuter shkencor, mbarim jonormal.*

Elementët përbërëse të togfjalëshave që kanë shpeshhtësi të lartë, në përgjithësi, janë fjalë të vetë fushës si: *maus, disk, disketë, informacion, internet, klikim, printer, skaner, kamera, kompjuterizim, tastierë, rrjet, imejl* etj.

## **BIBLIOGRAFI**

H. Pasho, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, "SF", 1985/2.

*Fjalori i informatikës anglisht-shqip, shqip-anglisht*, Prishtinë 2005.

A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në gjuhën shqipe*, "SF", 1982/4.